

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “ Për shërbimet e pagesave”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i Direktivës së BE-së si dhe nevojë e brendshme për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve të pagesave.
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva (EU) 2015/2366 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 Nëntor 2015 “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm” e cila amendon Direktivën 2002/65/EC, 2009/110/EC dhe 2013/36/EU si dhe rregulloren (EU) No 1093/2010, dhe zëvendëson Direktivë 2007/64/EC (Text with EEA relevance) OJ L 337, 23.12.2015, p. 35–127
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2019 – 2021 miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.201 datë 10.04.2019. Strategjia Kombëtare për Pagesat me Vlerë Të Vogël Në Shqipëri, miratuar në mbledhjen e IV^t datë 20.06.2018 të KKSP (Komiteti Kombëtar për Sistemet e Pagesave i cili funksionon mbi bazën e VKM nr. 37 datë 25.06.2014 të Bankës së Shqipërisë).
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	31.07.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	22.08.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 22.11.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019-MFE- 20
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Emri, Mbiemri, e-mail-i dhe numri i telefonit: Banka e Shqipërisë (Tel. +35542419301 (02,03,09,10,11) external: 1. Ledia Bregu, lbregu@bankofalbania.org 2240 2. Valentina Semi, vsemi@bankofalbania.org 3110 3. Irini Kalluci, ikalluci@bankofalbania.org 5014 4. Lindita Shehi, lshehi@bankofalbania.org 5085 5. Miranda Ramaj, mrماج@bankofalbania.org, 2370 6. Besjana Buqi, bbuqi@bankofalbania.org 3030 Ministria e Financave dhe Ekonomisë Hava Delibashi 0684381875 Hava.Delibashi@financa.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

(Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?

Problematikat dhe shkaqet:

Nga studime të ndryshme si dhe analiza të Bankës së Shqipërisë është evidentuar se ekonomia shqiptare karakterizohet nga **problematikat e (1) një përdorimi të lartë të parasë fizike (cash) dhe (2) përfshirja e ulët financiare**. Arsytet kryesore në lidhje me përdorimin e lartë të *cash*-it në ekonominë shqiptare vlerësohet se vjen si rezultat i një sërë faktorësh ku mund të përmendim:

- 1) Edukimin e ulët financiarë të popullsisë dhe një familjarizim i limituar i tyre me institucionet bankare e financiare;
- 2) Informalitetin e lartë në shkëmbimet tregtare në ekonomi;
- 3) Një treg bankar e financiar për shërbimet e pagesave i cili ka nevojë të harmonizojë praktika bashkëkohore nga pikëpamja e transparencës, mbrojtjes së konsumatorit, si dhe shërbimeve lehtësisht të përdorshme dhe me kosto financiare më të përballueshme nga publiku i gjerë;

Ndikimet negative të problematikave për të cilat është e nevojshme ndërhyrja

Vlen të theksohet se përdorimi i *cash*-it në ekonomi dhe përfshirja e ulët financiare vlerësohet të kenë ndikim negativ në ekonominë shqiptare në një sërë aspektesh si vijon:

- 1) Favorizon informalitetin në ekonominë shqiptare, redukton efektet e politikës monetare, krijon pengesa në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe atë financiar dhe për rrjedhojë ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit.
- 2) Mbart kosto të konsiderueshme për të gjithë aktorët ekonomikë dhe nuk nxit produktivitetin efikas të ekonomisë.
- 3) Ndikon negativisht në një sërë reformash të ndërmarra nga qeveria shqiptare për promovimin e digjitalizimit të shërbimeve të institucioneve shtetërore, promovimin e tregtisë elektronike dhe krijimin e kushteve të favorshme për nxitjen e dërgesave nga Diaspora.

Ndërhyrja e qeverisë shqiptare përtej nevojave për adresimin e çështjeve të sipërcituara nevojitet dhe nga pikëpamja e procesit të integritetit në Bashkimin Evropian në kuadër të liberalizimit të lëvizjes së lirë të kapitalit.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj politike janë:

- 1) Të nxitet përdorimi intensiv i instrumenteve moderne të pagesave, për të arritur rreth 10 pagesa në vit jo me para fizike për frymë, deri në fund të vitit 2022.
- 2) Të shtohen mundësitë për aksesin në llogaritë e pagesave, duke arritur një raport të zotërimit të llogarisë në nivelin 70% të popullsisë madhore, deri në vitin 2022.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës:

Opsioni 0 (status quo): Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues: Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”, së bashku me aktet rregullative përkatëse;

Opsioni 1: Hartimi i një ligji të ri;

Opsioni 2: Ndryshimi i ligjeve aktuale, përkatësisht Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet e opsionit të preferuar shihen në disa aspekte:

Ndikimet mbi buxhetin e shtetit:

Zbatimi i opsionit të preferuar nuk pritet të ketë ndikime direkte në buxhetin e shtetit në drejtim të rritjes së shpenzimeve, por mund të shoqërohet me rritjen e shpenzimeve të Bankës së Shqipërisë, pasi do të kërkojë shtimin e burimeve njerëzore për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave dhe implementimin dhe zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore. Nga ana tjetër, parashikohet një rritje e të ardhurave nga komisionet e licencimit të institucioneve të pagesave dhe nga volumet më të larta të transaksioneve në sistemet e pagesave, që administrohen nga Banka e Shqipërisë. Efekti neto do të ndikojë fitimin që Banka e Shqipërisë derdh në buxhetin e shtetit.

Ndikimi mbi bankat/subjektet financiare jobanka/SHKK-të dhe mbi institucionet e pagesave që do të licencohen:

Për subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit, do të nevojiten investime shtesë në drejtim të përshtatjes së sistemeve me kërkesat e reja të ligjit dhe riorganizimit të strukturave të tyre sipas kërkesave të reja ligjore. Ndërkohë, për subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash, do të nevojitet krijimi i strukturave, sistemeve dhe kontratave sipas kërkesave ligjore e nënligjore të reja.

Hyrja në fuqi e ligjit, pritet të ndikojë në rritjen e konkurrencës midis subjekteve që do të ofrojnë shërbimet e pagesave, në rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve të pagesave, si dhe në kostot dhe të ardhurat e tyre. Si rezultat i uljes së komisioneve për shërbimet që do të ofrohen nga subjektet, nga njëra anë dhe rritjes së bazës së klientëve/numrit të transaksioneve, nga ana tjetër, vlerësohet që efekti i ekonomisë të shkallës (*economy of scale*) do të jetë pozitiv.

Ndikimi mbi klientët (veçanërisht konsumatorët dhe mikrondërmarrjet):

Ligji parashikon kërkesa më të forta për sigurimin e transparencën ndaj klientëve (veçanërisht konsumatorëve dhe mikrondërmarrjeve). Njëkohësisht, subjektet duhet të krijojnë struktura dhe të hartojnë procedura për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve me klientët e tyre konsumatorë dhe mikrondërmarrje. Njëkohësisht krijimi i njësisë ZAM në Bankën e Shqipërisë, do të mundësojë shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve/mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave.

Sipas dispozitave të ligjit, është zgjeruar gama e shërbimeve të pagesave që mund të ofrohen tashmë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, por edhe e llojeve të ofruesve të shërbimeve të pagesave (të tillë si ofruesit e shërbimit të inicimit të pagesës ose ofruesit e shërbimit të

informimit mbi llogarinë), krahasuar me gamën e shërbimeve që aktualisht ofrohen nga bankat apo institucionet financiare jobanka (shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave).

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i zgjedhur është opsioni nr. 1 dhe është vlerësuar më i favorshëm për arsyet e mëposhtme:

1. Për nivelin e kompleksitetit është më e përshtatshme të jetë ligj i dedikuar që mbulon fushën e re të aktivitetit, përkundrejt ndryshimeve të ligjeve ekzistuese, të cilat mbulojnë edhe veprimtari të tjera.
2. Është marrë në konsideratë edhe eksperiencia e vendeve të ngjashme europiane të cilat e kanë transpozuar direktivën PSD2 me një ligj të veçantë.
3. Është marrë në konsideratë edhe sugjerimi i ekspertëve të Bankës Botërore për hartimin e një ligji të veçantë.

Kostoja e përlllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Nuk aplikohet	Nuk aplikohet	Nuk aplikohet

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?).

Projektligji është hartuar nga grupi i punës i krijuar nga Guvernatori i BSH, ku në përbërje të tij ishin përfaqësues të departamenteve të ndryshme në BSH (Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Mbikëqyrjes, Kabineti i Guvernatorit, Departamenti Juridik). Grupi i punës që nga krijimi i tij e deri në hartimin e projektligjit përfundimtar është mbështetur me ekspertizë të ofruar nga Banka Botërore dhe nga Banka Qendrore e Italisë.

Konsultimi i realizuar nga BSH:

- Periudha Shtator 2018;
- Publikimi në faqen e internetit të BSH, dhe dërgimi shkresor i publikimit për konsultim të projektligjit të subjektet e ligjit (bankat/subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK-të));
- Marrja e komenteve nga bankat/subjektet financiare jobanka;
- Përpilimi i tabelës së komenteve dhe arsyetimi për pranimin ose jo të secilit sugjerim nga komentet e bankave/subjekteve financiare jobanka;
- Takim me të gjitha subjektet që ishin pjesë e konsultimit të projekt-ligjit në ambientet e sallës së konferencave të BSH, ku u prezantua përmbajtja e projekt-ligjit si dhe u diskutuan edhe çështjet/komentet e ngritura nga subjektet gjatë konsultimit publik.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Institucioni përgjegjës për zbatimin e opsionit të preferuar do të jetë Banka e Shqipërisë, e cila nëpërmjet departamenteve apo njësisë të veçanta, do të jetë autoriteti përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave dhe të subjekteve të tjera të këtij ligji, për mbikëqyrjen e respektimit të kërkesave ligjore për lejimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave

për të operuar një sistem pagesash apo për të marrë pjesë në sistemet e pagesave, si dhe për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve ose mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Kërkesa e Komisionit Evropian për transpozimin e Direktivës 2007/64/EC “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm” është një kërkesë e hershme e cila fillon me analizimin dhe identifikimin e nevojave për ndërhyrje në legjislacionin vendas, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, dhe më konkretisht në kuadër të lëvizjes së lirë të kapitalit (Kapitulli 4) nga pikëpamja e shërbimeve të pagesave dhe përafrimit të praktikave të tregut Evropian për Tregun Unik të Pagesave në Euro (*Single Euro Payment Area*). Për të përmbushur këtë kërkesë, Banka e Shqipërisë ka përfshirë transpozimin e kësaj direktive në strategjinë e saj afatmesme që prej vitit 2011 dhe për këtë qëllim ka përfshirë këtë Direktivë dhe në asistencat teknike të përfuara nga Banka e Shqipërisë nga Komisioni Evropian (IPA, TAIEX). Megjithatë, bazuar në rekomandimet e ekspertëve të Bankave Qendrore të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian u dakordësua që Banka e Shqipërisë të shtynte procesin e transpozimit të Direktivës, pasi Komisioni Evropian në vitin 2012-2013 kishte iniciuar procesin e rishikimit të kësaj Direktive. Më në detaje, procesi i rishikimit të direktivës u finalizua në nëntor të vitit 2015, nëpërmjet Direktivës 2015/2366/EC dhe hyri në fuqi për vendet anëtare në janar të vitit 2018.

Banka e Shqipërisë, me qëllim arritjen e këtij objekti, përfshiu transpozimin e Direktivës 2015/2366/EC dhe në strategjinë afatmesme të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave¹ (2015-2020).

Vlen të theksohet se, nevoja për ndërhyrje në këtë drejtim është identifikuar edhe nga një sërë analizash dhe studimesh të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë me asistencën e Bankës Botërore², rekomandimet e të cilës u materializuan në një Strategji Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018-2023)³ e miratuar nga Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave në mbledhjen e tij të katërt, të mbajtur në datën 20 qershor 2018. Kështu, transpozimi i kësaj direktive përbën një nga objektivat më të rëndësishëm të planit të veprimit të strategjisë nga pikëpamja e ndërhyrjeve ligjore dhe ka për qëllim: “*Të krijojë një treg bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe eficient, dhe nga një gamë e gjerë e instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht për të kryer pagesa në të gjithë vendin. Qëllimi i strategjisë është që përmirësimet në tregun e*

¹ https://www.bankofalbania.org/rc/doc/strategjia_afatmesme_e_kksp_2_1_red_8177_1_9432.pdf

² https://www.bankofalbania.org/Pagesat/Komiteti_Kombetar_i_Sistemit_te_Pagesave/Mbledhja_e_Katert_Vjetore_e_Komitetit_Kombetar_te_Sistemit_te_Pagesave_20917.html

³ https://www.bankofalbania.org/rc/doc/STRATEGJIA_KOMB_TARE_P_R_PAGESAT_ME_VLER_T_VOG_L_N_SHQIP_RI_2018_12125.pdf

pagesave me vlerë të vogël t'u japin qytetarëve shqiptarë më shumë mundësi zgjedhjeje të vendeve të ndryshme për të kryer transaksionet e tyre të përditshme, në mënyrë të lehtë dhe me kosto efektive, duke mbështetur objektivin e një përfshirjeje më të gjerë financiare.”.

Në thelb, kjo strategji dhe ndërhyrjet ligjore në zbatim të saj synojnë nxiten e përfshirjes financiare dhe promovimin e përdorimit të instrumenteve elektronikë të pagesave duke përcaktuar dy objektiva të qartë dhe lehtësisht të matshëm si vijon:

- 1) Të nxitet përdorimi intensiv i instrumenteve moderne të pagesave, për të arritur rreth 10 pagesa/në vit jo me para fizike për frymë, deri në fund të vitit 2022.
- 2) Të shtohen mundësitë për aksesin në llogaritë e pagesave, duke arritur një raport të zotërimit të llogarisë në nivelin 70% të popullsisë madhore, deri në vitin 2022.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një përdorim i lartë i *cash*-it, një fakt ky i evidentuar edhe nga studime empirike të Bankës së Shqipërisë⁴. Përdorimi i lartë i *cash*-it në një farë mënyre mbështet informalitetin dhe krijon pengesa në zbatimin e politikës monetare, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe atë të stabilitetit financiar duke ndikuar kështu në zhvillimin ekonomik të vendit. Përtej ndikimeve në aspektin makroekonomik, përdorimi i *cash* si mjet pagese mbart kosto për të gjithë aktorët ekonomikë (individë, biznese, institucione shtetërore, institucione bankare e financiare që ofrojnë shërbime pagesash), të cilat arrijnë deri në 1,7 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Një nga faktorët kryesorë të përdorimit të gjerë të *cash*-it në ekonominë shqiptare është përfshirja e ulët financiare e popullsisë, e cila vlerësuar nga *Findex*⁵ (i publikuar nga Banka Botërore) identifikon se pothuajse 60 për qind e popullsisë nuk zotëron një llogari bankare. Përfshirja e ulët financiare e popullsisë përtej edukimit financiar të popullsisë dhe familjarizimit me sistemin bankar e atë financiar, vlerësohet se reflekton gjithashtu edhe kostot relativisht të larta të cilat mbartin shërbimet e ofruar aktualisht nga tregu si nga pikëpamja monetare ashtu edhe ajo kohore. Studimi i kryer nga Banka e Shqipërisë dikton se shumica dërrmuese e kostove që lidhen me përdorimin e instrumenteve në formë letër, të cilat përdoren gjerësisht në Shqipëri, janë kosto oportune të bazuara në kohën e shpenzuar, për faktin se ato kërkojnë praninë fizike dhe udhëtimin e pagesit/përfituesit në pothuajse të gjitha rastet duke ndikuar kështu në reduktimin e produktivitetit efektiv dhe gjenerimin e kostove nga mungesa e automatizimit të proceseve.

Përtej faktorëve të brendshëm të cilët janë identifikuar më lart, të cilët diktojnë nevojën për ndërhyrje me qëllim modernizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël, transpozimi i

⁴ https://www.bankofalbania.org/rc/doc/WB_RetailPmt_Abania_shqip_12354_1_12371.pdf

⁵ <https://globalfindex.worldbank.org/>

direktivës në një ligj kombëtar imponohet gjithashtu edhe nga procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Nevoja për përafrim të praktikave evropiane në tregun vendas të pagesave është një angazhim i ndërmarrë nga Shqipëria me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimi Asociimit dhe më konkretisht përbën një kërkesë të vazhdueshme të Bashkimit Evropian në kuadër të kapitullit 4 “ Lëvizja e lirë e kapitalit”.

Së fundi, duke marrë në konsideratë faktin se autoritet rregullatore dhe mbikëqyrëse në rrafshin ndërkombëtar po ballafaqohen me nevojat për rregullim të shërbimeve inovative të imponuara nga zhvillimi i teknologjisë në shërbimet financiare, të ashtuquajturën *Fintech* vlerësohet se transpozimi i kësaj Direktive në legjislacionin vendas, ashtu si dhe në Bashkimin Evropian, krijon parakushte që këto zhvillime teknologjike të promovohen në tregun vendas por duke vendosur kushte barazie me institucionet ekzistuese dhe duke garantuar sigurinë e këtyre shërbimeve inovative.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*
- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme:*

Është identifikuar si një nga problemet e parandalimit të përdorimit të lartë të instrumenteve elektronike dhe përfshirjes financiare mungesa e një kuadri ligjor i cili promovon dhe nxit konkurrencën dhe inovacionin në fushën e pagesave me vlerë të vogël të cilët janë promovues të shëndetshëm të efikasitetit të pagesave dhe reduktojnë kostot e përdorimit të tyre.

- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, synohet të adresohen problematikat aktuale të tregut shqiptar dhe të reduktohen ndikimet negative të këtyre problematikave në ekonominë shqiptare dhe në zhvillimin e mëtejshëm.

Ndërhyrja ligjore është e nevojshme për të krijuar parakushtet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve që mbart ekonomia shqiptare nga përdorimi i lartë i *cash-it* dhe përfshirja e ulët financiare. Përdorimi i *cash-it*, ashtu sikurse është evidentuar nga studimet e Bankës së Shqipërisë, jo vetëm mbart kosto për ekonominë në tërësi dhe frenon produktivitetin efikas të agentëve ekonomikë, por nga ana tjetër në thelb favorizon informalitetin e ekonomisë në tërësi.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të krijojë një treg bashkëkohor dhe gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurt dhe eficiente, dhe nga një gamë e gjerë e instrumenteve dhe shërbimeve të pagesave që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht për të kryer pagesa në të gjithë vendin. Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje është që përmirësimet në tregun e pagesave me vlerë të vogël t’u japin qytetarëve shqiptarë më shumë mundësi zgjedhjeje të vendeve të ndryshme për të kryer transaksionet e tyre të përditshme, në mënyrë të lehtë dhe me kosto efektive, duke mbështetur objektivin e një përfshirjeje më të gjerë financiare.

- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*

Shkalla e ndërhyrjes së qeverisë është thelbësore nëpërmjet propozimit për miratim të projektligjit të ri “Për shërbimet e pagesave” i cili në vijim plotësohet me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të tij nga Institucioni përgjegjës (Banka e Shqipërisë). Me miratimin e projektligjit vihen në lëvizje të gjithë mekanizmat e autoriteteve mbikëqyrëse dhe licensuese në zbatim të kuadrit të ri rregullator.

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Përdorimi i pagesave elektronike dhe si rrjedhojë reduktimi i përdorimit të *cash*-it vlerësohet se kanë një kontribut të rëndësishëm **në objektivat në nivel kombëtar të stabilitetit të çmimeve dhe atë financiar** dhe për rrjedhojë mbështetin **objektivin e lartë të qeverisë për zhvillimin ekonomik të vendit**. Gjithashtu, bazuar në rekomandime të fundit të Bashkimit Evropian, zbatimi i Strategjisë Kombëtare është tejet i rëndësishëm nga pikëpamja e stabilitetit financiar, ndërkohë që kjo nevojë është identifikuar dhe nga **rekomandimet e fundit të Moneyval për Shqipërinë**.

Promovimi i modernizimit të tregut të pagesave mbështet edhe **objektiva të tjera në nivel kombëtar si promovimi i digjitalizimit të shërbimeve qeveritare**, si dhe **planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën**.

Më konkretisht, zhvillimi paralel i portalit *e-Albania* dhe modernizimit të tregut të pagesave vlerësohet të mbështetin dhe të plotësojnë njëra-tjetrën, duke maksimizuar efikasitetin e shërbimeve të ofruara në *e-Albania* dhe duke mundësuar realizimin e shërbimeve të ofruara dhe pagesave respektive që këto shërbime mbartin, në mënyrë të shpejtë dhe efikase për qytetarët dhe bizneset.

Gjithashtu, projektligji është në linjë edhe me disa nisma ligjore të ndërmarra nga qeveria shqiptare të tilla si decentralizimi i mbrojtjes së konsumatorit, duke krijuar njësi ZAM në institucionet përgjegjëse të fushës dhe krijimi i kushteve për zbatimin sa më efikas në praktikë i tregtisë elektronike.

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Në lidhje me punën e realizuar deri më tani, ashtu si u shpjegua edhe në seksionin e “Historikut”, hartimi i projektligjit ka qenë një angazhim i hershëm i Bankës së Shqipërisë dhe për këtë qëllim janë realizuar një sërë analizash dhe studimesh të cilat konkluduan në krijimin e një grupi pune. Grupi i punës i ngritur me urdhër të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë kishte për objektiv hartimin e projektligjit, i cili transponon direktivën e rishikuar të Bashkimit Evropian “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”. Vlen të përmendet se hartimi i këtij projektligji është asistuar nga ekspertë të Bankës Botërore dhe Bankës Qendrore të Italisë. Ekspertët e Bankës Botërore do të vijojnë të asistojnë Bankën e Shqipërisë edhe në hartimin e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin dhe monitorimin e dispozitave ligjore pas hyrjes në fuqi.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë*

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet kësaj politike janë:

- 1) *Të nxitet përdorimi intensiv i instrumenteve moderne të pagesave, për të arritur rreth 10 pagesa/në vit jo me para fizike për frymë, deri në fund të vitit 2022.*
- 2) *Të shtohen mundësitë për aksesin në llogaritë e pagesave, duke arritur një raport të zotërimit të llogarisë në nivelin 70% të popullsisë madhore deri në vitin 2022.*

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës:

Opsioni 0 (status quo): Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues përkatësisht Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Ligji nr. 133/2013, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”, së bashku me aktet rregullative përkatëse; Të dyja këto dy ligje nuk trajtojnë shërbimet e pagesave dhe institucionet e pagesave. Nëse do të vazhdohej me këtë opsion, tregu shqiptar në një të ardhme të afërt do të përballej me prezencën e disa shërbimeve inovative të cilat nuk do të mund të rregulloheshin, licencoheshin e mbikëqyreshin nga Banka e Shqipërisë duke krijuar kështu ekspozime dhe kushte jo të barabarta konkurrence midis subjekteve të ndryshme që ofrojnë shërbime pagese. Nga ana tjetër, legjislacioni aktual, bazuar në analiza të shumta nevojitet përmirësim nga pikëpamja e transparencës dhe e mbrojtjes së konsumatorit. Kjo ndërhyrje, bëhet edhe më e domosdoshme si nga pikëpamja e procesit të integritetit evropian (ku Shqipërisë i është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme transpozimi i kësaj direktive) ashtu edhe në zbatim të strategjisë kombëtare për pagesat me vlerë të vogël 2018-2023. Për sa më sipër, vijim me kuadrin ligjor ekzistues do të cenonte një një sërë politikash dhe objektivash të qeverisë shqiptare.

Opsioni 1: Hartimi i një ligji të ri: Hartimi i një ligji të ri vlerësohet se do të ndihmonte ndjeshmen në kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të parashikuara. Theksohet se direktiva e cila po transpozhet është një direktivë mjaft komplekse dhe teknike, dhe përmban shumë referenca midis titujve dhe seksioneve të ndryshme. Në këto, kushte hartimi i një ligji të ri vlerësohet se e bënë më të lehtë kuptimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve të synuara. Gjithashtu ky ligj rregullon në mënyrë të detajuar veprimtarinë e të gjithë ofruesve të shërbimeve të pagesave (Titulli II i ligjit) dhe jo për shembull vetëm të bankave (gjë që mund të mbulohej nga përfshirja e dispozitave në Ligjin për bankat). Nevoja e hartimit të një akti të ri është eksperiencia e vendeve të ngjashme europiane, të cilat e kanë transpozuar direktivën PSD2 në një ligj të veçantë. Për më shumë, hartimi i një akti të ri është edhe sugjerimi i ekspertëve të Bankës Botërore për hartimin e një ligji të veçantë për transpozimin e Direktivës. Direktiva që përafrohet është voluminoze dhe komplekse në përmbajtjen e saj dhe në aspektin teknik dhe si e tillë nuk mund të bëhej pjesë e Ligjit për Bankat, apo e Ligjit për Sistemin e Pagesave.

Opsioni 2: Ndryshimi i ligjeve të cituara në Opsionin 0. Ashtu si dhe u shpjegua edhe më lartë, transpozimi i direktivës nëpërmjet ndërhyrjeve në aktet ligjore ekzistuese, jo vetëm do të krijonte konfuzion për çështjet e rregulluara nga kjo direktivë, por njëkohësisht mund të krijonte keqinterpretime edhe për çështjet e rregulluara aktualisht nga këto akte. Për sa më

sipër, ndërhyrjet në aktet ligjore aktuale nuk do të garantonin efikasitetin e synuar dhe mund të kishin efekte negative përgjatë zbatimit.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

• **Identifikoni se kush preket:**

Ndikimi i projektligjit të ri shtrihet në palët në vijim:

- Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit (bankat, subjektet financiare jobanka, SHKK-të) që ofrojnë shërbime pagesash dhe të transferimit të parave;
- Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash;
- Klientët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (veçanërisht konsumatorët dhe mikrondërmarrjet);
- Buxheti i shtetit/qeveria.

• **Llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur (ndikime të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta).**

Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit (bankat, subjektet financiare jobanka, SHKK-të) që ofrojnë shërbime pagesash dhe të transferimit të parave

✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**

- Mundësi për shtimin e aktivitetit për ofrimin e shërbimeve të pagesave;
- Përjasje më efektive e ofrimit të shërbimit si rrjedhojë e digjitalizimit të shërbimeve të pagesave;
- Krijimi i një ambienti të balancuar për rritjen e konkurrencës;
- Kosto për zhvillime infrastrukturore për t'u përshtatur me zhvillimet e reja si edhe përshtatje rregullative dhe procedurale për të zbatuar dispozitat ligjore.

- ✓ **Ndikim jo i drejtpërdrejtë**
 - Ridizenjim i proceseve si rrjedhojë e reduktimit të menaxhimit të cash-it dhe shfrytëzimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve.

Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash

- ✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**
 - Zgjerimi i gamës së aktivitetit në ofrimin e shërbimeve të pagesave;
 - Kontribut në një ambient të balancuar për rritjen e konkurrencës;
 - Nevoja për krijim të strukturave, sistemeve dhe kontratave sipas kërkesave ligjore e nënligjore të reja.
- ✓ **Ndikim jo i drejtpërdrejtë**
 - Rritja e gamës së inovacionit dhe presione mbi konkurrueshmërinë e subjekteve që operojnë në treg para hyrjes në fuqi të ligjit;
 - Promovimi dhe ndërgjegjësimi i përdoruesve të shërbimeve të pagesave nëpërmjet rritjes së edukimit financiar, kryesisht mbi instrumentet elektronike të pagesave.

Klientët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (veçanërisht për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet)

- ✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**
 - Zgjerimi i gamës së shërbimeve të pagesave të ofruara;
 - Përfitimi i shërbimeve të pagesave në një ambient më të mbrojtur në terma të mbrojtjes së konsumatorit (transparencë më e lartë dhe përcaktim i qartë i të drejtave dhe detyrimeve në kontratë, krijimi i ZAM);
 - Përfitimi i shërbimeve të pagesave më efikase dhe me kosto më të ulëta.
- ✓ **Ndikim jo i drejtpërdrejtë**
 - Përfshirje më e lartë financiare e klientëve që përdorin shërbimet e pagesave.

Buxheti i shtetit/qeveria

- ✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**
 - Nuk parashikohen ndikime direkte në buxhetin e shtetit;
- ✓ **Ndikim jo i drejtpërdrejtë**
 - Të ardhurat në buxhetin e shtetit

• Për ndikimet e drejtpërdrejta:

- Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
- Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
- Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
- Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme


• Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

- Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
- Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.

Lidhur me ndikimet e drejtpërdrejta


- Ndikimi mbi subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit (bankat/subjektet financiare jobanka/SHKK-të): Hyrja në fuqi e ligjit, pritet të ndikojë në rritjen e konkurrencës midis subjekteve që tashmë operojnë në treg dhe institucioneve të reja që do të hyjnë në këtë treg, në rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve të pagesave që do të ofrojnë, si dhe në kostot e ofrimit të shërbimeve dhe të ardhurat e tyre. Ndërsa konkurrenca pritet të ulë kostot e ofrimit të shërbimeve për klientët (që mund të përkthehet në më pak të ardhura për subjektet), kjo mund të rritë volumin e transaksioneve (që do të thotë më shumë të ardhura për subjektet), dhe në varësi të rezultantes së këtyre efekteve, do të shihet edhe efekti në të ardhurat totale të subjekteve. Vlen të theksohet se promovimi i inovacionit dhe dixhitalizimi do të kontribuojë edhe në zhvillimin e shërbimeve më efikase nga ana e bankave dhe institucioneve të tjera financiare që ofrojnë shërbimet e pagesave. Bazuar në studimet e Bankës së Shqipërisë, në bashkëpunim edhe me Bankën Botërore është evidentuar qartë se kostot e mbartura nga të gjithë aktorët ekonomikë nga përdorimi i *cash*-it dhe instrumenteve të pagesave në formë letër, janë të larta dhe zëvendësimi i tyre me pagesa elektronike, rrit produktivitetin efikas të ekonomisë shqiptare.

Grafiku 1: Kostot vjetore për ofruesit e pagesave dhe ofruesit e infrastrukturës sipas instrumentit të pagesës në % të PBB-së, për vitin 2016



Burimi: Studimi “KOSTOT DHE KURSIMET E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI”

Grafiku 2: Kostoja totale e ekonomisë (burimi) sipas instrumentit të pagesës në % të PBB-së së vitit 2016



Burimi: Studimi “KOSTOT DHE KURSIMET E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI”

Tabela 1: Skenarët e zëvendësimit dhe kursimet në nivel ekonomie

Skenarë Zëvendësimi /Fusha e kursimeve	Kursimet: Shkalla e konvertimit 35%			Kursimet: Shkalla e konvertimit 70%			Kursimet: Shkalla e konvertimit 100%		
	LEKË	\$	% e PBB 2016	LEKË	\$	% e PBB 2016	LEKË	\$	% e PBB 2016
Cash→Transferta Elektronike të Kreditit	3.5 miliardë	30.1 milionë	0.252	7.3 miliardë	62.8 milionë	0.526	11.8 miliardë	101.5 milionë	0.850
Cash→Kartë Debiti	1.9 miliardë	16.3 milionë	0.136	3.9 miliardë	33.5 milionë	0.280	7.9 miliardë	68 milionë	0.570
Cash→ Debitimi Direkt	1.8	15.5	0.130	4.2	36.1	0.302	7.7 miliardë	66.2	0.554

Elektronik	miliardë	milionë		miliardë	milionë			milionë	
Cash→Kartë Krediti	1.7 miliardë	14.6 milionë	0.122	3.5 miliardë	30.1 milionë	0.252	7.6 miliardë	65.4 milionë	0.548

Burimi: Studimi "KOSTOT DHE KURSIMET E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL NË SHQIPËRI"

- Gjithashtu, subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit, për të ofruar shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave, pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, do të nevojitet ta organizojnë veprimtarinë e tyre sipas kërkesave të reja. Kjo do të kërkojë investime shtesë në drejtim të sistemeve (të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e sigurisë, por edhe të përshtaten me kërkesat e reja të ligjit), të plotësimit të strukturave sipas kërkesave të reja ligjore dhe rritjes së kapaciteteve njerëzore për implementimin e ligjit, si dhe të rishikimit të formatit të kontratave (tip ose të transaksioneve individuale të pagesës). Përllogaritja e kostove për sa më sipër nuk mund të përllogaritet paraprakisht, pasi varet nga:

1. Pozicionimi i bankës/subjektit financiar jobankë ndaj hapësirave që krijon ligji, pra nëse nevojiten thjesht investime në zbatim të kërkesave të reja ligjore, apo nëse do kërkojë të përfitojë edhe nga avantazhi konkurrues, çka kërkon investime shtesë.
2. Situata aktuale e sistemeve ekzistuese të subjekteve (bankave/subjekteve financiare jobanka, etj.). Aktualisht, p.sh ka banka që kanë sisteme tejet moderne dhe të automatizuara dhe të tjera jo, kjo në varësi edhe të madhësisë së bankave apo të mbështetjes me sisteme të automatizuara nga bankat mëma.
3. Zgjedhja e ofruesit të shërbimeve që do i mbështesë këto zhvillime, p.sh. nëse do të jetë zgjidhje nga banka mëmë, një kompani e tretë totalisht e pavarur, si dhe çfarë zgjidhjesh do i kërkojnë nga banka për të zbatuar dispozita e ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ndikimi mbi subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash.

- Projektligji në fjalë u lejon subjekteve të reja të angazhohen në ofrimin e shërbimeve të pagesave, përfshirë edhe pagesat elektronike, si dhe në ofrimin e dy tipeve shërbimesh inovative për tregun shqiptar. Shërbimet inovative të promovuara nga ky projektligj konsistojnë në shërbimet e inicimit të pagesës dhe shërbimet e informimit të llogarisë. Me qëllim realizimin e shërbimeve të sipërcituara krijohet nga projektligji koncepti i shërbimit të llogarisë, i cili tipikisht ofrohet nga një bankë që jep informacion të konsoliduar mbi një ose më shumë llogari pagesash, të mbajtura nga përdoruesi me një (ose më shumë se një) ofrues tjetër të shërbimit të pagesave, pas autorizimit paraprak prej klientit, të ofruesve të shërbimeve të sipërcituara. Ky shërbim krijon konceptin e *open banking*, duke detyruar bankat të ndajnë informacionin mbi llogarinë e klientit me palë të treta, të cilat janë gjithashtu institucione të licencuara nga BSH (institucionet e shërbimit të inicimit të pagesës).

Gjithashtu, projektligji në fjalë synon të balancojë hapësirat për ofrimin e shërbimeve të pagesave midis bankave dhe institucioneve financiare jobanka, duke lejuar këto të fundit të hapin llogari pagese dhe të emetojnë instrumente elektronike të pagesave. Gjithashtu, në kuadër të ndërveprimit midis bankave dhe institucioneve financiare jobanka, projektligji parashikon dhe disa dispozita të cilat synojnë të eliminojnë praktikat bllokuese ndaj institucioneve financiare jobanka për arsye konkurrence. Më konkretisht projektligji:

- a. Sanksionon të drejtën e institucioneve të pagesave për të hapur llogari pranë një banke dhe për ofrimin e shërbimeve përkatëse. Në rast refuzimi banka duhet të raportojë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë arsyet e refuzimit. Kjo dispozitë synon të eliminojë praktikën abuzive të ndjekura nga bankat në kuadër të *derisking*.
- b. Sanksionon të drejtën e ofruesve të shërbimeve të pagesave për të marrë pjesë në sistemet e pagesave (në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur këto sisteme nuk janë me rëndësi sistemike dhe të tërthortë nëpërmjet një banke, kur ato janë me rëndësi sistemike si në rastin e sistemit AIPS).
- Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash, do të krijojnë strukturat, sistemet dhe kontratat sipas kërkesave ligjore e nënligjore të reja, duke kërkuar investime dhe duke shkaktuar kosto për këto subjekte.
- Matja e kostove dhe të ardhurave të cilat do të gjenerojnë këto subjekte është e pamundur të matet paraprakisht në fazën aktuale, pasi do të varet nga:
 - 1) Pozicionimi në treg i subjektit të ri, si dhe cilat nga shërbimet e pagesave, të cilat lejon ligji, do të përzgjedhë të ofrojë;
 - 2) Përqasja e institucionit në lidhje me investimet në infrastrukturë.

Ndikimi mbi klientët (veçanërisht mbi konsumatorët/mikrondërmarrjet):

- ***Rritja e gamës së shërbimeve financiare***

Projektligji parashikon 8 lloje të ndryshme të shërbimeve të pagesave, që mund të ofrohen tashmë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave, duke zgjeruar dhe detajuar gamën e shërbimeve që aktualisht ofrohen nga bankat apo institucionet financiare jobanka (shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave).

- ***Transparencë***

Projektligji parashikon kërkesa më të forta për transparencën ndaj klientëve (veçanërisht konsumatorëve dhe mikrondërmarrjeve), duke siguruar dhënien e informacioneve të detajuara dhe zakonisht pa kosto mbi transaksionet e kryera si dhe mbi baza periodike.

- ***Mbrojtja e konsumatorëve***

Ligji parashikon kërkesa për subjektet për hartimin e procedurave të posaçme për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, për ankesat e klientëve të tyre konsumatorë dhe mikrondërmarrje. Njëkohësisht parashikohet krijimi i një njësie të veçantë ZAM në Bankën e Shqipërisë, e cila do të shqyrtojë dhe zgjidhë mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet konsumatorëve ose mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave për shkelje të pretenduara të këtij ligji nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave, jo në rrugë gjyqësore.

- ***Ulje e kostove të transaksioneve***

Rritja e konkurrencës midis aktorëve të rinj dhe atyre që do të hyjnë në tregun e ofrimit të shërbimeve të pagesave, pritet të ndikojë në uljen e kostove të ofrimit të këtyre shërbimeve.

- ***Rritja e efikasitetit të shërbimeve financiare***

Krijimi i hapësirave ligjore për licencimin/regjistrimin e disa lloj ofruesish të shërbimeve të pagesave me një natyrë të veçantë (të tillë si ofruesit e shërbimit të inicimit të pagesës ose ofruesit e shërbimit të informimit të llogarisë), pritet të japë efektet e veta në drejtim të përmirësimit të efikasitetit të ofrimit të shërbimeve, shkurtimeve të kohës së kryerjes së transaksioneve apo uljes së kostove.

Ndikimet mbi buxhetin e shtetit/qeverinë:

- Nuk ka ndikime direkte në buxhetin e shtetit në drejtim të rritjes së shpenzimeve, pasi nuk parashikohet ndonjë veprim konkret që do të ndikonte buxhetin e shtetit.

Lidhur me ndikimet jo të drejtpërdrejta

Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit (bankat/ subjektet financiare banka/SHKK-të)

Këto subjekte do të nevojitet të ridizenjojnë proceset e tyre, si rrjedhojë e reduktimit të menaxhimit të *cash*-it dhe njëkohësisht në drejtim të shfrytëzimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve.

Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash

- Hyrja në treg e institucioneve të reja të pagesave, do të promovojë inovacionin dhe ofrimin e shërbimeve më efikase, duke rritur njëkohësisht edhe presionet për subjektet që operojnë në treg para hyrjes në fuqi të ligjit (bankat dhe institucionet e tjera financiare që ofrojnë shërbime pagesash), në drejtim të rritjes së konkurrencës. Me qëllim që të jenë konkurrues, këto subjekte do të duhet të përshtaten me zhvillimet e tregut dhe shërbimet inovative që do të ofrojnë institucionet e pagesave që do të licencohen rishtazi.
- Institucionet e pagesave që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin kryesisht të instrumenteve elektronike të pagesave, por edhe të shërbimeve të tjera inovative. Kjo do të realizohet nëpërmjet ndërgjegjësimit të përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe një pune intensive në drejtim të rritjes së edukimit financiar për t'i njohur këta përdorues me shërbimet e reja në dispozicion të tyre dhe me mënyrat më të shpejta dhe efikase të realizimit të transaksioneve. Klientët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (veçanërisht konsumatorët dhe mikrondërmarrjet).

Nëpërmjet hapësirave që krijon projektligji për shërbimet e pagesave dhe llojeve të ndryshme të këtyre shërbimeve, si dhe nëpërmjet krijimit të një ambienti më të mbrojtur për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet, parashikohet që të sigurohet një përfshirje më e lartë financiare e klientëve që përdorin shërbimet e pagesave. Kjo përfshirje më e lartë do të sigurohet nëpërmjet ofrimit të shërbimeve me agentë (tashmë edhe për bankat), apo nëpërmjet kryerjes së pagesave në distancë (elektronike), duke krijuar mundësinë që shërbimet e pagesave të ofrohen tashmë edhe për individët që jetojnë në zona rurale apo të largëta.

Ndikimet mbi buxhetin e shtetit/qeverinë:

- Zbatimi i ligjit, mund të rritë shpenzimet e Bankës së Shqipërisë të lidhura me rritjen e kapaciteteve njerëzore për licencimin dhe mbikëqyrjen e implementimit dhe zbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore. Nga ana tjetër, ka pritshmëri që do të rriten të ardhurat nga licencimi i institucioneve të pagesave dhe të ardhurat që lidhen me volumet e rritura të transaksioneve në sistemet e pagesave (që priten të kenë efekt

brenda 3-5 vitesh, pas përshtatjes me kërkesat e reja ligjore dhe aktivitetin e ri). Efekti neto do të ndikojë fitimin e derdhur për buxhetin e shtetit.

- *Diskutoni kufizimin e analizës:*

- o *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- o *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
- o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

Supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe rreziqet janë:

- 1) Ekzistenca e një kuadri ligjor të unifikuar për rregullimin e institucioneve të pagesave dhe shërbimeve të pagesave, sipas praktikave më të mira të Bashkimit Evropian vlerësohet se do të mbështesë reformimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri, duke mbështetur promovimin e pagesave elektronike dhe përfshirjen financiare në Shqipëri;
- 2) Zgjidhja e shpejtë, e drejtë dhe efikase e mosmarrëveshjeve, si dhe nxitja e transparencës, për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet në veçanti, por edhe aktorët e tjerë ekonomikë në tërësi, vlerësohet se do krijojë një treg efikas i cili do të mbështesë nevojat e tyre duke promovuar kështu përdorimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare dhe duke u diktuar drejt shërbimeve më efikase të ofruara nga ana e këtyre institucioneve.

Supozimet e mësipërme bazohen në një sërë studimesh dhe analizash të kryera nga Banka e Shqipërisë, me mbështetjen e Bankës Botërore ku mund të përmendim:

- 1) Analizën “Përfshirja efektive financiare në Shqipëri: Perspektiva e Pagesave”;
- 2) Studimin “Kostot dhe kursimet e pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri”;
- 3) Konkluzionet e disa projekteve me Bankat Qendrore të Bashkimit Evropian në kuadër të Planit të Integritetit me Bashkimin Evropian.

Rreziqet më të mëdha për të penguar realizimin e përfitimeve/ pritshmërive pas miratimit të ligjit të ri “Shërbimet e Pagesave” janë si vijojnë:

- 1) Ndjekja e politikave konservatore dhe jo konkurruese e inovatore nga ana e bankave dhe institucioneve të tjera financiare në fushën e pagesave, si rrjedhojë e politikave të tyre për zhvillim, e ndikuar kjo dhe nga zhvillimet ekonomike në vend por dhe më gjerë (nëse merret në konsideratë se shumë nga këto subjekte kanë aksionerë të huaj);
- 2) Moszbatimi korrekt i ligjit nga subjektet;
- 3) Mungesë interesi nga të ashtuquajturit kompanitë *FinTech* për të hyrë në tregun shqiptar, si rrjedhojë e madhësisë dhe volumeve të ulëta të transaksioneve të pagesave që ka tregu shqiptar aktualisht.

- ***Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:***

- o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- o *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

NR.	Subjektet e licencuara	Subjektet që do të licencohen	Klientët	Buxheti i shtetit/qeveria
<i>A/Ndikime të drejtëpërdrejta</i>				
1	Mundësi për shtimin e aktivitetit për ofrimin e shërbimeve të pagesave	Zgjerimi i gamës së aktivitetit në ofrimin e shërbimeve të pagesave	Zgjerimi i gamës së shërbimeve të pagesave të ofruara	Nuk parashikohen ndikime të drejtëpërdrejta
2	Përqasje më efektive e ofrimit të shërbimit si rrjedhojë e digjitalizimit të shërbimeve të pagesave	Kontributi në një ambient të balancuar për rritjen e konkurrencës	Përfitim i shërbimeve të pagesave në një ambient më të mbrojtur në terma të mbrojtjes së konsumatorit (transparencë më e lartë dhe përcaktim i qartë i të drejtave dhe detyrimeve në kontratë, krijimi i ZAM)	
3	Krijimi i një ambienti të balancuar për rritjen e konkurrencës	Nevoja për krijim të strukturave, sistemeve dhe kontratave sipas kërkesave ligjore e nënligjore të reja	Përfitim i shërbimeve të pagesave më efikase dhe me kosto më të ulëta	
4	Kosto për zhvillime infrastrukturore për t'u përshtatur me zhvillimet e reja si edhe përshtatje rregullative dhe proceduriale për të zbatuar dispozitat ligjore			
<i>B/ Ndikime jo të drejtëpërdrejta</i>				
1.	Ridizenjim i proceseve si rrjedhojë e reduktimit të menaxhimit të <i>cash</i> -it dhe shfrytëzimi i kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve	Rritja e gamës së inovacionit dhe presione mbi konkurrueshmërinë e subjekteve që operojnë në treg para hyrjes në fuqi të ligjit.	Përfshirje më e lartë financiare e klientëve që përdorin shërbimet e pagesave.	Të ardhurat në buxhetin e shtetit
2.		Promovimi dhe ndërgjegjësimi i përdoruesve të shërbimeve të pagesave nëpërmjet rritjes së edukimit financiar, kryesisht mbi instrumentet elektronike të pagesave.		

Opsioni 0 (status quo): Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues:

Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit (bankat, subjektet financiare jobanka, SHKK-të)

✓ **Ndikim i drejtëpërdrejta**

- Mungesë incentivimi për ofrimin e shërbimeve të pagesave inovative, të cilat rezultojnë të jenë dhe më efikase;
- Mungesë e një ambienti të balancuar për nxitjen e konkurrencës;
- Vijimi i fokusit tek produkte më tradicionale, si depozitat dhe kreditë, duke mos diversifikuar veprimtaritë e ofruara.
- Kushte transparence dhe procedura për mbrojtjen e konsumatorit, të limituara

Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash

✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**

- N/A – në rastin e përzgjedhjes së opsionit 0 (pra, mosndryshim i kuadrit ligjor/rregullativ ekzistues - status quo), nuk do të ketë ndikim në institucionet e pagesave, pasi kuadri ligjor/rregullativ ekzistues nuk parashikon licencimin e institucioneve të pagesave të mirëfillta, por mund të licencohen vetëm në formën e subjekteve financiare jobanka që ofrojnë shërbime pagesash dhe të transferimit të parave).

Klientët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (veçanërisht konsumatorët dhe mikrondërmarrjet)

✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**

- Gamë e limituar e shërbimeve elektronike të cilat mund të përdorin për shërbimet e tyre.
- Mungesë e një kuadri prudencial për mbrojtjen e klientit dhe në veçanti konsumatorët dhe mikrondërmarrjet.
- Kosto të larta të përdorimit të shërbimeve të pagesave, si rrjedhojë e një përjasje jo shumë konkurruese dhe mungese të zbatimit të praktikave inovative.

Opsioni 2: Ndryshimi i ligjeve të cituara në Opsionin 0.

Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë para hyrjes në fuqi të ligjit (subjektet financiare jobanka, SHKK-të)

✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**

- Vështirësi në kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të cilat mund të kenë efekte negative në zhvillimin e tregut.

Subjektet që do të licencohen pas hyrjes në fuqi të ligjit, si institucione pagesash

✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**

- Vështirësi në kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të cilat mund të kenë efekte negative në zhvillimin e tregut.

Klientët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (veçanërisht konsumatorët dhe mikrondërmarrjet)

✓ **Ndikim i drejtpërdrejtë**

- Për shkak të vështirësive në kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit nga ana e institucioneve të cilat do të ofrojnë këto shërbime, do të ndikohen edhe klientët e tyre.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i zgjedhur 1, është vlerësuar më i favorshëm për arsyet e mëposhtme:

- Për nivelin e kompleksitetit është më e përshtatshme të jetë ligj i dedikuar që mbulon fushën e re të aktivitetit, përkundëjt ndryshimeve të ligjeve ekzistuese, të cilat mbulojnë edhe veprimtari të tjera.
- Eksperienca e vendeve të ngjashme europiane të cilat e kanë transpozuar direktivën PSD2 me një ligj të veçantë.
- Direktiva që përafrohet është e gjatë dhe teknike dhe nuk mund të bëhet pjesë e Ligjit për bankat, apo Ligjit për Sistemin e Pagesave.

- Sugjerimi i ekspertëve të Bankës Botërore për ligj të veçantë.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Njësitë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të preferuar do të jenë si më poshtë:

- Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë do të jetë struktura që do të ndjekë zbatimin e ligjit në drejtim të licencimit dhe të mbikëqyrjes së Institucioneve të Pagesave dhe të gjithë subjekteve të tjera të këtij ligji, si dhe do të hartojë aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës i Bankës së Shqipërisë do të jetë struktura që do të ndjekë zbatimin e ligjit në drejtim të respektimit të kërkesave ligjore për lejimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave për të operuar një sistem pagesash ose për të marrë pjesë në sistemet e pagesave.
- Njësia ZAM që do të krijohet në Bankën e Shqipërisë, do të shqyrtojë dhe zgjidhë mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet konsumatorëve ose mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave për shkelje të pretenduara të këtij ligji nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave, jo në rrugë gjyqësore.
- Departamenti Juridik i Bankës së Shqipërisë do të jetë struktura që do të mbështesë Departamentin e Mbikëqyrjes, Departamentin e Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Njësinë ZAM për përputhshmërinë ligjore dhe rregullative në procesin e zbatimit të ligjit dhe të hartimit të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Banka e Shqipërisë, në funksion të përmbushjes së objektivave të saj strategjike, do të monitorojë në vazhdimësi zbatimin e opsionit të përzgjedhur, kryesisht në drejtim të:

- Analizave periodike nga jashtë (*offsite*) dhe mbikëqyrjes në vend (*onsite*) të subjekteve të licencuara prej saj. Rezultat i mbikëqyrjes në vend është një raport ekzaminimi i përgatitur nga Banka e Shqipërisë, ku identifikohet ecuria dhe arritjet e subjekteve gjatë kohës që ekzaminohet, por edhe mangësitë dhe problematikat e vërejtura. Procesi mbikëqyrës realizohet në mbështetje dhe zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi për Bankën e Shqipërisë dhe për bankat, subjektet financiare jobanka dhe SHKK-të.
- Monitorimit të përdorimit të hapësirave të krijuara nga kuadri i ri ligjor/rregullativ nga ana e aktorëve ekzistues dhe të rinj të tregut të pagesave;
- Monitorimit të zhvillimeve infrastrukturore nga ana e bankave, me qëllim lehtësimin e aksesimit të llogarive të klientëve nga institucionet e pagesave, si dhe pjesëmarrjen e këtyre të fundit në sistemet e pagesave;

- Monitorimit të rishikimit të kontratave nga aktorët ekzistues të tregut, por edhe hartimi i tyre nga subjektet e reja që do të licencohen, në zbatim të kushteve të transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit.
- Vlerësimin të përdorimit të pagesave elektronike dhe si rrjedhojë, reduktimi i përdorimit të parasë fizike (*cash*) në ekonominë shqiptare, si pasojë e një edukimi më të mirë dhe një përfshirje më të lartë financiare, nëpërmjet statistikave/të dhënave të grumbulluara.
- Ndjekjes në vazhdimësi të numrit të ankesave të paraqitura në njësinë e veçantë ZAM për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve / mikrondërmarrjeve dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe të zgjidhjeve të dhëna.

Si tregues bazë për matjen e qëllimeve, do të shërbejë përmbushja e hapave të mësipërm, mbikëqyrja e vazhdueshme e zbatimit të kërkesave të reja ligjore e nënligjore, statistikave e përfutura nga subjektet apo njësia ZAM, si dhe arritja e objektivave sasiorë të vendosur që në fillim të këtij dokumenti. Gjithashtu, një objektiv i matshëm në këtë drejtim mund të jetë krijimi / konvertimi i 4 deri në 5 institucione pagesash në vitin e parë të zbatimit të ligjit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Efektet financiare opsionit të preferuar janë të pamundura të vlerësohen pasi gjithçka varet nga pozicionimi strategjik i institucioneve për të përfituar nga avantazhet konkurruese që mund t'i ofrojë ligji si dhe nga infrastruktura ekzistuese e sistemeve që zotërojnë bankat. Vlerësimi i volumeve të pritshme dhe efekteve në kosto për 10 vitet e ardhshme, është i pamundur të vlerësohet dhe parashikohet me informacionin aktual.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										

Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	
---	--

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			